

VENDIM
Nr. 682, datë 23.10.2019

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA
E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK AGJENCIA SHETETËRORE E
KADASTRËS, TË PASURISË NR. 3/200, ZONA KADASTRALE 8561, ME
EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË
PUNËSIMIT, KORÇË”, NJËSIA ADMINISTRATIVE KORÇË DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë nr. 3/200, zona kadastrale 8561, me emërtimin “Ish-Drejtorja Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë”, njësia administrative Korçë, sipas hartës kadastrale, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Korçë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.

3. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

